



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

NJËSIA E HARTIMIT TË DOKUMENTAVE TË TENDERIT

Nr. _____ prot.

Himarë , më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “ZGJERIMI I VARREZAVE TË FSHATIT VUNO”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45215400-1 -
Punime ndërtimi për varreza**

VLERA E FONDIT: 2 354 868,89 (dy milionë e treqind e pesëdhjetë e katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë presje tetëdhjetë e nëntë) **Lekë pa TVSH**

Përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj)”. Inxhinieri është mbështetur në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga organet kompetente, e cila duhet të përfshijë kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- *NP-1 A: Punime gjurmimi në tokë;*
- *NP-12 A: Punime të inxhinierisë së mjedisit.*

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- *NS-4 A: Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to;*
- *NS-18 A: Punime topogjeodezike.*

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit që, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit, merr përsipër të realizojë.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë, të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (ose ministrisë kompetente të kohës) në Republikën e Shqipërisë, referuar VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet.

Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”, nenin 39, pika 6, gërma (a), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit

Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”6. *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore*”, Ligjin Nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998 të ndryshuar, VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar.

Bazuar në natyrën e punimeve të parashikuara në preventive, licencat e kërkuara janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin dhe volumet e punimeve që do të realizohen.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë licencë profesionale të shoqërisë me kategoritë NP-1, NP-12, NS-4 dhe NS-18 është përcaktuar duke u bazuar në natyrën, kompleksitetin dhe proceset teknike të punimeve të parashikuara në preventive.

Kategoritë e licencave të kërkuara nuk janë përcaktuar në mënyrë të përgjithshme, por në funksion të zërave konkretë të preventivit dhe proceseve të punës që kërkojnë kapacitete profesionale të përshtatshme për realizimin e tyre.

Duke qenë se vlera e kontratës për kategoritë përkatëse të punimeve është brenda kufirit që korrespondon me klasifikimin “A”, është përcaktuar niveli A i licencimit. Kjo kërkesë synon të garantojë që operatori ekonomik të ketë kapacitetet profesionale të nevojshme për realizimin e punimeve, pa tejkaluar nivelin e kërkuar nga vlera dhe natyra e objektit.

1. NP-1 A – Punime gjurmimi në tokë

Kërkesa për kategorinë NP-1 A – Punime gjurmimi në tokë lidhet drejtpërdrejt me punimet e parashikuara për përgatitjen e terrenit dhe formimin e trupit të objektit. Realizimi i zgjerimit të varrezave kërkon paraprakisht ndërhyrje në terren, përfshirë gjurmime për krijimin e kuotave dhe niveleve të projektit, përgatitjen e bazamentit, hapësirave të varrezave, elementeve konstruktive dhe shtresave të parashikuara në preventiv. Gjurmimet nuk përbëjnë një proces të izoluar, por janë pjesë themelore e zinxhirit teknologjik të ndërtimit, pasi kuotat dhe nivelet e realizuara gjatë këtij procesi përcaktojnë kushtet e mëtejshme për ndërtimin e shtresave, mureve dhe elementeve të tjera të objektit. Për këtë arsye, kërkesa për NP-1 A është teknikisht e lidhur me objektin dhe konsiderohet e nevojshme për garantimin e realizimit korrekt të punimeve të gjurmimit, sistemimit dhe përgatitjes së terrenit.

2. NP-12 A – Punime të inxhinierisë së mjedisit

Kërkesa për kategorinë NP-12 A – Punime të inxhinierisë së mjedisit lidhet me karakterin e objektit dhe me ndërhyrjet që realizohen në terren për sistemimin, stabilizimin dhe përmirësimin e kushteve të tij. Objekti i zgjerimit të varrezave përfshin ndërhyrje në një territor ekzistues dhe kërkon që punimet të realizohen në mënyrë të tillë që të garantohet stabiliteti i terrenit, disiplinimi dhe administrimi i ujërave sipërfaqësore, mbrojtja e sipërfaqeve nga degradimi dhe integrimi i ndërhyrjes së re me terrenin përreth. Punimet e gjurmimit, shtresave të ndryshme të bazamentit dhe mbushjeve, elementeve prej betoni dhe betonarmeje, si dhe sistemimet me materiale të forta, ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në mënyrën se si territori do të sillet ndaj ujërave atmosferike, erozionit dhe proceseve të degradimit të terrenit.

Në këtë kuptim, kërkesa për NP-12 A lidhet me nevojën që punimet të realizohen duke marrë në konsideratë jo vetëm aspektin konstruktiv, por edhe sistemimin dhe qëndrueshmërinë e territorit ku realizohet ndërhyrja.

3. NS-4 A – Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to

Kërkesa për kategorinë NS-4 A – Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to lidhet me punimet e përfundimit, sistemimit dhe trajtimit të elementeve ndërtimore që do të realizohen në kuadër të objektit. Në preventiv janë parashikuar punime të lidhura me elemente murature, sipërfaqe të ndërtuara dhe përfundime, si dhe punime me materiale të ndryshme për sistemimin dhe përfundimin e hapësirave. Këto procese kërkojnë njohuri dhe kapacitete profesionale për realizimin e saktë të sipërfaqeve, lidhjeve, niveleve dhe përfundimeve, në mënyrë që elementi i ndërtuar të jetë funksional, i qëndrueshëm dhe në përputhje me kërkesat teknike të projektit.

Në veçanti, në një objekt si zgjerimi i varrezave, punimet e muraturës dhe rifiniturave kanë rëndësi jo vetëm nga pikëpamja estetike, por edhe për krijimin e një hapësire të sistemuar, të qëndrueshme dhe të përshtatshme për përdorimin e parashikuar. Për këtë arsye, kërkesa për NS-4 A është e lidhur me natyrën e punimeve të parashikuara në preventiv dhe me proceset teknike që duhet të realizohen gjatë zbatimit të kontratës.

4. NS-18 A – Punime topogjeodezike

Kërkesa për kategorinë NS-18 A – Punime topogjeodezike është e lidhur me nevojën për realizimin e saktë të objektit sipas kuotave, akseve, pozicionit planimetrik dhe niveleve të përcaktuara në projekt.

Gjatë zbatimit të punimeve të zgjerimit të varrezave, shërbimet topogjeodezike janë të nevojshme për përcaktimin në terren të pozicionit të punimeve, piketimin e elementeve, kontrollin e kuotave dhe verifikimin e niveleve të shtresave dhe elementeve konstruktive. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për punimet e gërmimit, përgatitjen e bazamentit, realizimin e shtresave, mureve dhe elementeve të tjera të parashikuara, pasi devijimet nga kuotat dhe pozicionet e projektit mund të ndikojnë në funksionalitetin, qëndrueshmërinë dhe përputhjen e objektit të përfunduar me projektin teknik. Punimet topogjeodezike nuk kufizohen vetëm në fazën fillestare të piketimit, por janë të nevojshme edhe gjatë kontrollit të vazhdueshëm të zbatimit, për verifikimin e kuotave dhe dimensioneve të punimeve të realizuara. Për këtë arsye, NS-18 A është një kategori që lidhet drejtpërdrejt me procesin teknik të zbatimit të objektit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ndarja e kategorive të licencave sipas zërave të preventivit dhe pjesës së punimeve që merr përsipër secili anëtar siguron që çdo pjesë e kontratës të mbulohet nga kapaciteti profesional përkatës. Në këtë mënyrë, kriteri i licencimit është i lidhur me objektin e kontratës dhe me proceset teknike të parashikuara për realizimin e tij.

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që

operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës....”; nenin 43 pika 2/c dhe pika 3, nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku parashikohen se:

“2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme”.

“3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor”.

“Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”.*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”.*

Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.*

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron është vendosur konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për:

- një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 29 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 95 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së kryer.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së kryer, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore si dhe me situacionet e punimeve dhe akt-kolaudimin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se ”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ku parashikohet se ”Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: a) Për kontratat e punëve:

i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 29 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Referuar nenit 55 pika 4 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të

ndryshuar, është përcaktuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 29 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

Përcaktimi i vlerës minimale prej 95% të vlerës limit të kontratës synon të sigurojë që operatori ekonomik të ketë një eksperiencë reale dhe të konsoliduar në realizimin e punimeve të ngjashme, në një volum ekonomik të konsiderueshëm dhe të krahasueshëm me përmasat e kontratës objekt prokurimi. Ky nivel kërkesë është i arsyeshëm duke pasur parasysh se kontrata përfshin një kombinim të punimeve të prishjes, gërmimit, transportit, ndërtimit të shtresave konstruktive, betonimit dhe shtrimit të sipërfaqeve me gur natyral.

Kërkesa është vendosur duke respektuar përcaktimin ligjor sipas të cilit, për kontratat e punëve në procedurat e thjeshtuara, vlera e punëve të ngjashme të kërkuara në total gjatë pesë viteve të fundit nuk duhet të jetë më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Në rastin konkret, kërkesa prej 95% është më e ulët se kufiri maksimal prej 100% të vlerës limit të kontratës dhe, për rrjedhojë, qëndron brenda kufirit të përcaktuar nga kuadri ligjor.

Në përputhje me përcaktimin ligjor, kriteri është konceptuar në mënyrë alternative, duke parashikuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve të përvojës së ngjashme e bën ofertën të kualifikueshme. Për rrjedhojë, operatorët ekonomikë kanë mundësi të dëshmojnë kapacitetin e tyre profesional ose nëpërmjet realizimit të një pune të ngjashme për një objekt të vetëm, brenda kufirit të përcaktuar përkatësisht nga legjislacioni, ose nëpërmjet realizimit të disa punëve të ngjashme, vlera monetare totale e të cilave plotëson pragun e kërkuar.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë personelin kryesor drejtues teknik, të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe që figuron në listëpagesën e shoqërisë për muajin Korrik 2026, si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi;
- 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet;
- 1 (një) inxhinier mjedisi;

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomë, kontratë pune, CV dhe librezë pune.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, të renditur i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të vetëdeklaruara, si dhe dokumenteve të tjera shoqëruese të ofertës të paraqitura në rrugë elektronike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e

nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Kërkesa për këtë përbërje të stafit teknik synon të garantojë që gjatë zbatimit të kontratës të jenë të mbuluara në mënyrë të përshtatshme tre komponentë thelbësorë të punimeve: zbatimi konstruktiv dhe ndërtimor, kontrolli topografik dhe aspekti i sistemit dhe mbrojtjes së territorit/mjedisit. Personeli i kërkuar është i lidhur drejtpërdrejt me kategoritë e licencës profesionale të kërkuara për shoqërinë dhe me natyrën e punimeve të parashikuara në preventiv.

1. Inxhinier ndërtimi: Kërkesa për 1 (një) inxhinier ndërtimi justifikohet nga natyra kryesisht ndërtimore dhe infrastrukturore e punimeve të parashikuara në objekt. Realizimi i zgjerimit të varrezave përfshin punime gjurmimi, përgatitje dhe sistemim të terrenit, realizim të shtresave të ndryshme, punime betoni dhe betonarmeje, mure dhe elemente të tjera konstruktive, si dhe punime përfundimtare dhe sistemime të hapësirës. Inxhinieri i ndërtimit është personeli teknik përgjegjës për ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të këtyre proceseve në përputhje me projektin teknik, specifikimet teknike dhe kërkesat e zbatimit. Prania e këtij profili është e nevojshme për kontrollin e cilësisë së materialeve dhe punimeve, respektimin e parametrave teknikë, kontrollin e mënyrës së realizimit të elementeve konstruktive, si dhe koordinimin e proceseve të ndryshme të ndërtimit. Duke qenë se punimet përfshijnë elemente konstruktive dhe ndërhyrje të ndryshme në terren, drejtimi teknik nga një inxhinier ndërtimi garanton që proceset e zbatimit të kryhen sipas kërkesave të projektit dhe standardeve teknike përkatëse. Për këtë arsye, kërkesa për një inxhinier ndërtimi është e lidhur drejtpërdrejt me objektin dhe përbën një kapacitet teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës.

2. Inxhinier topograf/gjeodet: Kërkesa për 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet lidhet me nevojën për realizimin dhe kontrollin e saktë planimetrik dhe altimetrik të punimeve. Punimet e parashikuara kërkojnë ndërhyrje në terren dhe realizimin e elementeve të ndryshme në kuota dhe pozicione të përcaktuara në projekt. Për këtë arsye, gjatë zbatimit është e nevojshme të kryhen piketimi i objektit dhe elementeve të tij, përcaktimi i akseve, kontrolli i kuotave dhe niveleve, si dhe verifikimi i përputhjes së punimeve të realizuara me projektin.

Inxhinieri topograf/gjeodet siguron kontrollin e këtyre parametrave gjatë fazave të ndryshme të zbatimit, duke përfshirë përgatitjen e terrenit, gjurmimet, realizimin e shtresave, mureve dhe elementeve të tjera që kërkojnë pozicionim dhe nivelim të saktë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme pasi gabimet në pozicionim ose në kuota gjatë fazave fillestare mund të ndikojnë në

mënyrë të drejtpërdrejtë në punimet pasuese dhe në përputhjen përfundimtare të objektit me projektin. Për këtë arsye, disponimi i një inxhinieri topograf/gjeodet konsiderohet i nevojshëm për garantimin e saktësisë së zbatimit të punimeve.

3. Inxhinier mjedisi: Kërkesa për 1 (një) inxhinier mjedisi lidhet me karakterin e ndërhyrjes në territor dhe me nevojën për administrimin e aspekteve mjedisore që shoqërojnë realizimin e punimeve. Objekti realizohet në një territor ekzistues dhe përfshin punime gjurmimi, lëvizje dhe sistemim të materialeve, ndërhyrje në terren, realizim të shtresave dhe elementeve të ndryshme ndërtimore dhe sistemim të sipërfaqeve. Gjatë zbatimit është e nevojshme që këto procese të kryhen duke minimizuar ndikimet e padëshiruara në territorin përreth, duke garantuar administrimin e materialeve të dala nga gjurmimet, mbajtjen e pastërtisë së kantierit, sistemimin e terrenit dhe respektimin e kërkesave mjedisore që lidhen me procesin e ndërtimit. Inxhinieri i mjedisit siguron mbikëqyrjen e komponentit mjedisor të punimeve dhe ndihmon në koordinimin e masave që duhet të merren gjatë zbatimit për mbrojtjen e territorit dhe parandalimin e ndikimeve negative të punimeve. Kërkesa për këtë profil lidhet gjithashtu me natyrën e kategorisë së licencimit NP-12 – Punime të inxhinierisë së mjedisit, të kërkuar për shoqërinë, dhe synon që kapaciteti teknik i operatorit ekonomik të jetë i mbështetur nga personel me formimin profesional përkatës.

Kërkesa për këto tre profile profesionale është përcaktuar duke marrë në konsideratë se procesi i zbatimit të objektit nuk përbëhet vetëm nga punime të karakterit konstruktiv, por kërkon njëkohësisht kontroll të saktë të pozicionimit dhe kuotave si dhe administrim të aspekteve që lidhen me terrenin dhe mjedisin.

Në këtë kuadër inxhinieri i ndërtimit mbulon drejtimin dhe kontrollin e proceseve ndërtimore dhe konstruktive, inxhinieri topograf/gjeodet mbulon piketimin, matjet, kuotat, akset dhe kontrollin planimetrik e altimetrik, inxhinieri i mjedisit mbulon aspektet mjedisore dhe sistemimin e territorit gjatë zbatimit të punimeve.

Kërkesa që personeli kryesor drejtues teknik të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të figurojë në listëpagesën e saj për muajin e fundit synon të garantojë disponimin real dhe efektiv të kapaciteteve profesionale të deklaruara nga operatori ekonomik.

Drejtnesit teknikë duhet të jenë persona që kanë lidhje profesionale reale me operatorin ekonomik dhe që mund të angazhohen në ndjekjen e zbatimit të kontratës, në përputhje me përgjegjësitë e tyre profesionale.

Kërkesa për paraqitjen e diplomës, kontratës së punës, CV-së dhe librezës së punës shërben për të dokumentuar formimin profesional, marrëdhënien e punës dhe përvojën e personelit të deklaruar. Ndërkohë, përdorimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit si provë paraprake dhe kërkimi i dokumenteve provuese nga ofertuesi i kualifikuar i renditur i pari synon të verifikojë në mënyrë të dokumentuar përmbushjen e kriterit përpara shpalljes së fituesit dhe fillimit të afateve të ankimit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, të pajisur me diplomë ose dëshmi përkatës, të lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, si dhe të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për muajin Korrik 2026, si më poshtë:

- 1 (një) elektrikist;
- 1 (një) saldator;

- *1 (një) teknik ndërtimi;*
- *1 (një) manovrator (i cili mund të disponohet nga operatori ekonomik edhe nëpërmjet kontraktimit).*

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Për dokumentacionin provues zbatohen përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit” si dhe VKM Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, Urdhërin Nr. 109, datë 05.08.2013 ”Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, pasi për kryerjen e punimeve të veçanta sipas zërave të preventivit kërkohen specialistët e sipërpërmendur.

Qëllimi i vendosjes së këtij kriteri shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas specifikimeve teknike si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve, volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike.

Kërkesa për punonjës të specializuar synon të garantojë që proceset konkrete të punës të kryhen nga persona me formimin dhe kualifikimin profesional përkatës, duke garantuar sigurinë, cilësinë dhe zbatimin korrekt të punimeve.

1. Elektricitist: Kërkesa për 1 (një) elektricitist lidhet me nevojën për realizimin, mirëmbajtjen dhe kontrollin e punimeve dhe elementeve elektrike që mund të jenë pjesë e zbatimit dhe funksionalizimit të objektit. Gjatë realizimit të punimeve ndërtimore, përdorimi i pajisjeve dhe mjeteve elektrike, instalimeve të përkohshme të kantierit dhe elementeve elektrike të parashikuara në objekt kërkon ndërhyrjen e një punonjësi të kualifikuar për këto procese. Elektricitisti është i nevojshëm për realizimin dhe kontrollin e punimeve elektrike sipas kërkesave teknike, si dhe për garantimin e përdorimit të sigurt të instalimeve dhe pajisjeve elektrike gjatë fazës së zbatimit.

Disponimi i një punonjësi të kualifikuar në këtë profil siguron që ndërhyrjet që lidhen me instalimet elektrike të mos kryhen nga personel i pakualifikuar dhe që proceset përkatëse të realizohen në përputhje me kërkesat teknike dhe të sigurisë. Për këtë arsye, kërkesa për një elektricitist është përcaktuar si një kapacitet profesional mbështetës për realizimin dhe funksionalizimin e objektit.

2. Saldator: Kërkesa për 1 (një) saldator lidhet me nevojën për realizimin e punimeve që përfshijnë elemente metalike dhe lidhjet ndërmjet tyre, aty ku këto procese parashikohen gjatë zbatimit të objektit.

Punimet e ndërtimit dhe sistemit mund të kërkojnë përpunimin, përshtatjen, bashkimin ose riparimin e elementeve metalike të ndryshme, përfshirë elemente ndihmëse, konstruktive apo të tjera të lidhura me realizimin e objektit. Procesi i saldimit kërkon njohuri dhe aftësi specifike profesionale, pasi cilësia e lidhjeve të salduara ndikon në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e elementeve ku ato aplikohen. Për këtë arsye, disponimi i një saldatori të kualifikuar siguron që punimet e saldimit dhe ndërhyrjet në elementet metalike të kryhen nga personel me kompetencën profesionale të nevojshme. Kërkesa për këtë profil është veçanërisht e lidhur me nevojën që, gjatë zbatimit të punimeve, operatori ekonomik të ketë në dispozicion personel të aftë për të kryer menjëherë ndërhyrjet teknike që kërkojnë aftësi specifike në përpunimin dhe bashkimin e elementeve metalike.

3. Teknik ndërtimi: Kërkesa për 1 (një) teknik ndërtimi lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve të objektit dhe me nevojën për personel teknik që të mbështesë drejtimin dhe zbatimin praktik të proceseve të ndryshme ndërtimore. Tekniku i ndërtimit shërben si personel teknik mbështetës në organizimin dhe ndjekjen e proceseve të punës në kantier, duke kontribuar në zbatimin praktik të punimeve sipas projektit, preventivit dhe udhëzimeve të drejtimit teknik. Në kuadër të objektit, ku parashikohen punime gërmimi, përgatitje dhe sistemim terreni, realizim shtresash, punime betoni dhe betonarmeje, mure dhe punime të tjera ndërtimore, nevojitet një personel teknik që të ndjekë nga afër proceset e realizimit dhe të bashkërendojë punën e punonjësve të specializuar. Prania e teknikut të ndërtimit krijon një hallkë të rëndësishme ndërmjet drejtimit teknik dhe forcës së punës në kantier, duke ndihmuar në organizimin dhe kontrollin e proceseve të përditshme të zbatimit.

Për këtë arsye, kërkesa për një teknik ndërtimi është në përputhje me natyrën e punimeve dhe me nevojën për një strukturë të përshtatshme të personelit në kantier.

4. Manovrator: Kërkesa për 1 (një) manovrator lidhet me natyrën e punimeve që kërkojnë përdorimin e mjeteve dhe makinerive të ndryshme për realizimin e proceseve të punës. Punimet e gërmimit, sistemit dhe përgatitjes së terrenit, si dhe proceset e transportimit, ngarkimit, shpërndarjes dhe përpunimit të materialeve, kërkojnë përdorimin e mjeteve dhe makinerive të përshtatshme. Përdorimi i këtyre makinerive duhet të kryhet nga personel i kualifikuar, në mënyrë që të garantohet realizimi i punimeve me efikasitet dhe, njëkohësisht, siguria e punonjësve dhe e personave të tjerë që ndodhen në zonën e punimeve. Për këtë arsye, disponimi i një manovratori

është i lidhur drejtpërdrejt me proceset e gërmimit, sistemimit dhe transportimit të materialeve që shoqërojnë zbatimin e objektit.

Duke marrë në konsideratë natyrën e këtij profili dhe faktin se disponimi i tij mund të sigurohet edhe nëpërmjet kontraktimit, kriteri lejon operatorin ekonomik të sigurojë këtë kapacitet profesional sipas mënyrës së organizimit të punës dhe nevojave të kantierit.

Këto profile janë të ndryshme nga personeli kryesor drejtues teknik i kërkuar në kriterin 2.3.2, pasi kanë karakter më të specializuar dhe lidhen me zbatimin praktik të proceseve të veçanta të punës. Kombinimi i tyre siguron që operatori ekonomik të ketë në dispozicion jo vetëm drejtimin teknik të nevojshëm, por edhe fuqinë punëtore të specializuar për realizimin praktik të proceseve specifike të kontratës.

Kërkesa që punonjësit të jenë të pajisur me diplomë ose dëshmi përkatëse të lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore synon të sigurojë që personat e deklaruar të kenë formimin dhe kualifikimin profesional të nevojshëm për pozicionin përkatës.

Kërkesa që punonjësit të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për muajin Korrik 2026, synon të garantojë disponimin real të kapacitetit njerëzor të deklaruar nga operatori ekonomik.

Për manovratorin, kriteri parashikon shprehimisht mundësinë e disponimit edhe nëpërmjet kontraktimit, duke i dhënë operatorit ekonomik mundësi fleksibiliteti në sigurimin e këtij kapaciteti profesional, pa cenuar nevojën që personi i angazhuar të jetë i kualifikuar për përdorimin e makinerive përkatëse.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, ndërsa verifikimi i dokumentacionit provues do të kryhet në përputhje me përcaktimet përkatëse të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore, për muajin Korrik 2026, prej minimalisht 10 (dhjetë) personash.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Kriteri do të vërtetohet me:

a) vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore;

b) listëpagesa e punonjësve, të konfirmuar nga autoritetet përkatëse, të shoqëruara me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Për dokumentacionin provues zbatohen përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Kriteri lidhet drejtpërdrejt me natyrën, volumet dhe organizimin e punimeve të parashikuara në specifikimet teknike.

Ky numër përfaqëson minimumin e nevojshëm për të garantuar që punimet të zhvillohen paralelisht, me cilësi dhe në përputhje me kërkesat për siguri, mjedis dhe afate. Një numër më i ulët do të detyronte operatorin të kryente proceset në mënyrë të fragmentuar, duke rritur rrezikun e vonesave, uljes së cilësisë dhe mosrespektimit të kushteve teknike të kontratës.

Kërkesa që operatori ekonomik pjesëmarrës të disponojë, për realizimin e punimeve objekt kontrate, fuqi punëtore prej minimalisht 10 (dhjetë) personash, është përcaktuar në funksion të natyrës së punimeve, volumit të proceseve të punës, nevojës për realizimin paralel të disa proceseve në kantier dhe afatit të realizimit të kontratës.

Numri minimal prej 10 punonjësish nuk është përcaktuar si një kërkesë e përgjithshme për numrin e punonjësve të operatorit ekonomik, por si një kapacitet minimal njerëzor i nevojshëm për organizimin dhe realizimin efektiv të punimeve të objektit.

Objekti “Zgjerimi i varrezave të fshatit Vuno” përfshin një sërë procesesh ndërtimore që nuk realizohen në mënyrë të njëpasnjëshme vetëm nga një grup i kufizuar punonjësish, por kërkojnë angazhimin e një numri të përshtatshëm punonjësish në kantier, në mënyrë që proceset të mund të organizohen dhe të zhvillohen sipas rendit teknologjik të punimeve.

Në funksion të natyrës së punimeve të parashikuara në preventiv, nevoja për fuqi punëtore lidhet veçanërisht me proceset e mëposhtme:

- a) gjurmimet dhe përgatitjen e terrenit;
- b) ngarkimin, transportimin dhe sistemimin e materialeve;
- c) përgatitjen dhe realizimin e shtresave të ndryshme;
- d) punimet me materiale inerte dhe stabilizuese;
- e) realizimin e punimeve prej betoni dhe betonarmeje;
- f) realizimin e mureve dhe elementeve të tjera ndërtimore;
- g) punimet e sistemit dhe përfundimit të sipërfaqeve;
- h) punimet me gurë natyralë dhe materiale të tjera të parashikuara në preventiv;
- i) punimet ndihmëse dhe të organizimit të kantierit;
- j) përdorimin dhe asistimin në përdorimin e mjeteve dhe makinerive të nevojshme për zbatimin e punimeve.

Numri prej 10 punonjësish përfaqëson kapacitetin minimal njerëzor të nevojshëm për të organizuar punimet në mënyrë të vazhdueshme dhe për të shmangur ndërprerjen e një procesi pune për shkak të mungesës së fuqisë punëtore.

1. Për punimet e gjurmimit dhe përgatitjes së terrenit kërkohen 3 punonjës. Këta punonjës nevojiten për realizimin e punëve manuale të shoqëruara me gjurmimin mekanik, pastrimin e zonës së

ndërhyrjes, sistemimin e materialit të gërmuar, nivelimin dhe përgatitjen e sipërfaqes së punës. Në rastet kur përdoren makineri, punonjësit janë të nevojshëm për asistimin e procesit, orientimin e materialit, punët manuale në zona ku makineritë nuk mund të operojnë dhe përgatitjen e terrenit për fazën pasuese. Tre punonjës për këtë proces krijojnë mundësinë që puna mekanike dhe puna manuale të zhvillohen në mënyrë të koordinuar, pa e ngarkuar të gjithë fuqinë punëtore të kantierit vetëm me këtë proces.

2. Për ngarkimin, transportimin dhe sistemimin e materialeve kërkohen 2 punonjës. Këta punonjës angazhohen në punët që lidhen me lëvizjen e materialeve brenda kantierit, ngarkimin dhe shkarkimin manual aty ku është e nevojshme, shpërndarjen e materialeve në zonat e punës dhe sistemimin e tyre. Ky proces duhet të zhvillohet në koordinim me gërmimet, shtresat, betonin dhe punimet e tjera, pasi materialet duhet të jenë të disponueshme në kohën dhe vendin ku kërkohen. Dy punonjës të dedikuar për këtë funksion shmangin ndërprerjen e punonjësve të angazhuar në proceset kryesore për të kryer transportin ose sistemimin e materialeve.

3. Për realizimin e shtresave me materiale inerte kërkohen 3 punonjës. Procesi i shtresave përfshin shpërndarjen e materialit, nivelimin, sistemimin manual të sipërfaqes, korrigjimin e zonave ku kërkohet ndërhyrje manuale dhe përgatitjen e sipërfaqes për ngjeshje. Tre punonjës janë të nevojshëm për të realizuar në mënyrë të koordinuar këto veprime, ndërkohë që makineria ose mjeti i ngjeshjes kryen funksionin mekanik. Për këtë arsye, edhe në prani të mjeteve mekanike, procesi kërkon fuqi punëtore të mjaftueshme për përgatitjen, shpërndarjen dhe korrigjimin e materialit.

4. Për punimet e betonit dhe betonarmesë kërkohen 4 punonjës. Ky proces kërkon angazhim të njëkohshëm të disa punonjësve për përgatitjen e zonës së betonimit, transportimin dhe furnizimin me material, vendosjen, shpërndarjen, nivelimin dhe përpunimin e betonit, si dhe për punët ndihmëse të lidhura me armaturën dhe kallëpet, sipas elementit që realizohet. Katër punonjës lejojnë që një pjesë e grupit të merret me furnizimin dhe përgatitjen, ndërsa pjesa tjetër të kryejë vendosjen dhe përpunimin e betonit. Ky është një proces që kërkon ritëm dhe koordinim dhe nuk është e arsyeshme të realizohet vetëm nga një ose dy punonjës, pasi kjo do të ulte ndjeshëm ritmin e punës.

5. Për realizimin e mureve kërkohen 3 punonjës. Punimet e mureve kërkojnë punë të koordinuar për përgatitjen e bazamentit, transportimin e materialeve në pikën e punës, përgatitjen e materialit lidhës, vendosjen e elementeve të murit, nivelimin dhe kontrollin e vazhdueshëm të realizimit. Tre punonjës mundësojnë që ndërkohë që një ose dy punonjës realizojnë vendosjen dhe sistemimin e elementeve të murit, punonjësi tjetër të sigurojë furnizimin me material dhe punët ndihmëse. Kjo mënyrë organizimi shmang ndërprerjen e vazhdueshme të punës së muratorit për të siguruar materiale.

6. Për punimet me gurë natyralë kërkohen 3 punonjës. Punimet me gurë kërkojnë angazhim të konsiderueshëm manual për përzgjedhjen, transportin, vendosjen, pozicionimin, përshtatjen dhe sistemimin e gurëve. Tre punonjës janë të nevojshëm për të siguruar vazhdimësinë e procesit, pasi një pjesë e grupit duhet të merret me furnizimin dhe pozicionimin e gurëve, ndërsa pjesa tjetër me vendosjen dhe përpunimin e tyre. Ky organizim është veçanërisht i nevojshëm për të ruajtur ritmin e punimeve dhe për të shmangur kohën e humbur nga mungesa e materialit në pikën e punës.

7. Për punimet e sistemimit dhe përfundimit kërkohen 2 punonjës. Këta punonjës nevojiten për nivelimin dhe sistemimin e sipërfaqeve, pastrimin e zonave të punës, korrigjimin e elementeve të përfunduar, largimin e materialeve të tepërta dhe kryerjen e punimeve manuale të nevojshme për

përfundimin e objektit. Këto punime duhet të realizohen në mënyrë të vazhdueshme gjatë fazave të ndryshme të zbatimit dhe jo vetëm në fund të kontratës, pasi sistemimi i një zone është shpesh kusht për vijimin e punimeve në zonën pasuese.

8. Për punët ndihmëse dhe organizimin e kantierit kërkohen 1 punonjës. Ky punonjës nevojitet për punë të ndryshme mbështetëse, përfshirë sistemimin e mjeteve dhe materialeve, pastrimin e zonave të punës, asistimin e proceseve mekanike, largimin e mbetjeve dhe kryerjen e punëve të tjera manuale që janë të domosdoshme për funksionimin e rregullt të kantierit. Këto detyra janë të vazhdueshme dhe nuk mund të neglizhohen, pasi mungesa e tyre ndikon në organizimin dhe ritmin e punimeve.

Nga analiza e mësipërme rezulton se numri i punonjësve të nevojshëm për proceset individuale është më i madh se 10 nëse të gjitha proceset do të zhvilloheshin njëkohësisht. Kjo nuk përbën kontradiktë me kërkesën për minimalisht 10 punonjës, pasi numrat e mësipërm përfaqësojnë nevojën e fuqisë punëtore për secilin proces kur ai është në fazën aktive dhe jo një kërkesë që të gjithë punonjësit e secilit proces të jenë të ndryshëm dhe të angazhuar njëkohësisht gjatë gjithë periudhës së kontratës.

Në praktikë, fuqia punëtore prej 10 punonjësish riorganizohet dhe rialokohet sipas fazës së punimeve. Për shembull, gjatë fazës së gërmimeve mund të angazhohen 3 punonjës në gërmime, 2 punonjës në transport dhe sistemim materialesh, 3 punonjës në përgatitjen e shtresave dhe 2 punonjës në punët ndihmëse dhe sistemimin e kantierit. Në këtë mënyrë arrihet përdorimi i plotë i fuqisë punëtore pa pasur nevojë për një numër të veçantë punonjësish për çdo proces.

Në fazën e betonit dhe betonarmesë, organizimi mund të ndryshojë, duke angazhuar 4 punonjës në procesin e betonimit dhe betonarmimit, 2 punonjës në furnizimin dhe transportin e materialeve, 2 punonjës në përgatitjen dhe sistemimin e zonave të punës dhe 2 punonjës në proceset e tjera mbështetëse. Kjo siguron që procesi kryesor të mos ndërpritet për mungesë të materialeve apo të punëve ndihmëse.

Në fazën e realizimit të mureve dhe punimeve me gurë, fuqia punëtore mund të riorganizohet duke angazhuar 3 punonjës në muraturë, 3 punonjës në punimet me gurë, 2 punonjës në transportin dhe furnizimin me materiale dhe 2 punonjës në sistemimin dhe punët ndihmëse. Kështu, numri minimal prej 10 punonjësish mundëson realizimin e proceseve të ndryshme në mënyrë të koordinuar dhe, kur kushtet teknike e lejojnë, paralelisht.

Në fazën përfundimtare, fuqia punëtore mund të rialokohet në mënyrë që 3 punonjës të angazhohen në punimet e sistemimit, 3 punonjës në punimet përfundimtare dhe korrigjimet, 2 punonjës në transportin dhe largimin e materialeve dhe mbetjeve dhe 2 punonjës në punët ndihmëse dhe organizimin e kantierit.

Për këtë arsye, kërkesa për minimalisht 10 punonjës duhet interpretuar si kërkesë që operatori ekonomik të disponojë një bazë minimale prej 10 punonjësish të aftë për t'u organizuar dhe rialokuar sipas fazave dhe nevojave të punimeve.

Kjo mënyrë organizimi është e domosdoshme për të garantuar vazhdimësinë e punimeve, për të shmangur ndërprerjet ndërmjet proceseve, për të siguruar furnizimin në kohë me materiale dhe për të mundësuar realizimin e disa proceseve në mënyrë të koordinuar.

Në përfundim, kërkesa për 10 (dhjetë) punonjës është përcaktuar si kapacitet minimal njerëzor për realizimin e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve, proceset konkrete të

ndërtimit, nevojën për punë manuale, përdorimin e makinerive, furnizimin dhe sistemimin e materialeve, organizimin e kantierit dhe respektimin e afatit të realizimit.

Numri prej 10 punonjësish përbën një prag minimal të arsyeshëm për të garantuar që operatori ekonomik të ketë mundësi reale të organizojë fuqinë punëtore sipas fazave të zbatimit dhe të realizojë objektin “Zgjerimi i varrezave të fshatit Vuno” në mënyrë të vazhdueshme, të koordinuar dhe në përputhje me kërkesat teknike dhe kontraktore.

Për të dëshmuar këtë kapacitet, operatorët ekonomikë vetëdeklarojnë disponimin e fuqisë punëtore në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, përfshirë vërtetimin e administratës tatimore, listëpagesat dhe dokumentet përkatëse të deklarimit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, verifikohet në përputhje me përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Mjetet/Pajisjet	Sasia	Gjendja
1	Kamion me kapacitet mbajtës mbi 3.5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
2	Eskavator me zinxhirë	1 copë	Në pronësi ose me qira
3	Fadromë me goma	1 copë	Në pronësi ose me qira
4	Betonierë kantieri	1 copë	Në pronësi ose me qira
5	Matrapik	1 copë	Në pronësi ose me qira

Për mjetet në pronësi duhet të paraqiten:

- a) dokumenti që vërteton pronësinë e mjetit;
- b) leja e qarkullimit;
- c) certifikata e kontrollit teknik;
- ç) siguracioni i mjetit, i vlefshëm.

Për mjetet e deklaruar me qira duhet të paraqiten:

- a) kontrata noteriale e qirasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;
- b) dokumenti që vërteton pronësinë e mjetit;
- c) leja e qarkullimit;
- ç) certifikata e kontrollit teknik;
- d) siguracioni i mjetit, i vlefshëm.

Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara si të rrezikshme sipas legjislacionit në fuqi, duhet të paraqitet certifikata për transport mallrash të rrezikshëm, e lëshuar nga institucionet përkatëse dhe e vlefshme.

Për pajisjet teknike në pronësi duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes ose fatura tatimore e blerjes, si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes.

Kur pajisjet janë marrë me qira, duhet të paraqitet:

- kontrata e qirasë;
- kontrata e shitblerjes ose fatura tatimore e blerjes;
- dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes.

Për mjetet dhe pajisjet teknike të deklaruar, operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara, duhet të jetë e dukshme në një foto të

vetme si mjeti, ashtu edhe targa e tij.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- deklaratë për pranimin e verifikimit të mjeteve dhe pajisjeve nga Autoriteti Kontraktor në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës;*
- deklaratë që mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë deklaruar në procedura të tjera të shpallura fituese;*
- deklaratë mbi vendndodhjen e mjeteve dhe pajisjeve, me qëllim verifikimin nga Autoriteti Kontraktor.*

Disponimi i mjeteve dhe pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Për dokumentacionin provues zbatohen përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

Nëpërmjet kësaj kërkesë, operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Lloji dhe numri i mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës është përcaktuar duke u bazuar në zerrat e preventivit dhe specifikimeve teknike. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Përcaktimi i pajisjeve dhe makinerive është bërë duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit, mundësive të manovrimit me mjete të rënda, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes etj.

Kërkesa që operatori ekonomik pjesëmarrës të disponojë mjetet dhe pajisjet e përcaktuara në kriterin e kualifikimit është përcaktuar në funksion të natyrës, kompleksitetit dhe mënyrës së realizimit të punimeve objekt kontrate, si dhe për të garantuar që operatori ekonomik të ketë

kapacitetet teknike dhe logjistike të nevojshme për realizimin e punimeve brenda afatit të përcaktuar dhe sipas kërkesave të dokumentacionit teknik.

Punimet e parashikuara në preventiv përfshijnë ndër të tjera punime gërmimi me eskavator, punime dheu dhe transport të materialeve të ndërtimit dhe të dheut, punime mbushjeje dhe sistemimi të trupit të rrugës, realizim të shtresave me materiale të ndryshme dhe shtresë betoni, ndërtim të mureve prej guri mbajtës dhe themeleve, prerje dhe sistemim të pemëve, punime të konstruksioneve metalike të thjeshta, lysterje dhe bojatisje të konstruksioneve metalike, prishje të mureve prej guri, si dhe punime për vendosjen e shtyllave dhe ndriçuesve, shtrimin e kabllave dhe vendosjen e tubacioneve plastike mbrojtëse.

Në këtë kuadër, mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë të lidhura drejtpërdrejt me proceset teknologjike të parashikuara dhe janë si më poshtë:

1. Kamion me kapacitet mbajtës mbi 3.5 ton – 1 copë

Kërkesa për kamion është e nevojshme për realizimin e punimeve që lidhen me transportin dhe largimin e materialeve të gërmuara, dheut, materialeve të ndërtimit dhe materialeve të tjera të nevojshme për realizimin e kontratës.

Duke qenë se preventivi përfshin punime gërmimi, transport dhe sistemim të materialeve, një mjet transporti me kapacitet mbi 3.5 ton është i nevojshëm për të siguruar transportin e materialeve në mënyrë të vazhdueshme dhe efikase, duke shmangur ndërprerjet e procesit të punës dhe duke mundësuar realizimin e punimeve sipas grafikut të zbatimit.

2. Eskavator me zinxhirë – 1 copë

Eskavatori me zinxhirë kërkohet për realizimin e punimeve të gërmimit dhe punimeve të dheut të parashikuara në preventiv.

Ky mjet është i domosdoshëm për gërmimet për themele, gërmimet për realizimin dhe sistemimin e trupit të rrugës, punimet e hapjes dhe profilimit të terrenit, si dhe për ngarkimin dhe manipulimin e materialeve të gërmuara.

Përdorimi i eskavatorit me zinxhirë është veçanërisht i përshtatshëm për punime në terrene të ndryshme dhe për zona ku kërkohet stabilitet dhe kapacitet i lartë pune gjatë gërmimit dhe sistemimit të materialit.

3. Fadromë me goma – 1 copë

Fadroma me goma është kërkuar për kryerjen e punimeve të ngarkimit, transportit në distanca të shkurtra dhe shpërndarjes së materialeve të gërmuara dhe të materialeve të ndërtimit. Kjo pajisje lidhet me zërat e preventivit që kanë të bëjnë me punimet e dheut, mbushjet me material të gërmuar, sistemimin e trupit të rrugës, përhapjen dhe manipulimin e materialeve të shtresave, si dhe me ngarkimin e materialeve për transport. Fadroma siguron fleksibilitet dhe shpejtësi në lëvizjen e materialeve në kantier dhe plotëson funksionin e mjeteve të tjera të rënda të kërkuara për realizimin e punimeve.

4. Betonierë kantieri – 1 copë

Betonierja e kantierit kërkohet për përgatitjen dhe furnizimin me beton gjatë realizimit të punimeve të parashikuara në preventiv. Ajo lidhet veçanërisht me realizimin e shtresës së betonit, themeleve dhe elementeve të tjera prej betoni që mund të jenë pjesë e punimeve të ndërtimit dhe sistemimit të parashikuara në projekt. Disponimi i betonieres në kantier mundëson përgatitjen e betonit pranë frontit të punimeve, duke siguruar vazhdimësinë e procesit teknologjik dhe përshtatjen e prodhimit me nevojat konkrete të punimeve.

5. Matrapik – 1 copë

Matrapiku është kërkuar për realizimin e punimeve të prishjes të parashikuara në preventiv, veçanërisht për prishjen e mureve prej guri dhe punime të tjera të ngjashme që kërkojnë thyerje, çmontim ose heqje të materialeve ekzistuese. Përdorimi i kësaj pajisjeje mundëson realizimin e punimeve të prishjes në mënyrë më të shpejtë dhe efikase dhe është i përshtatshëm për ndërhyrje në struktura ekzistuese prej guri dhe materiale të ngjashme.

Kërkesa për disponimin e 1 (një) kamioni me kapacitet mbajtës mbi 3.5 ton, 1 (një) eskavatori me zinxhirë, 1 (një) fadrome me goma, 1 (një) betoniere kantieri dhe 1 (një) matrapiku është përcaktuar mbi bazën e një lidhjeje të drejtpërdrejtë ndërmjet mjeteve/pajisjeve të kërkuara dhe proceseve të punës të parashikuara në preventiv.

Kërkesa për këto mjete dhe pajisje synon garantimin e kapacitetit real teknik dhe operacional të operatorit ekonomik për të realizuar punimet e gërmimit, transportit dhe manipulimit të materialeve, punimet e dheut dhe sistemimit, punimet e betonit dhe themeleve, si dhe punimet e prishjes, duke siguruar organizimin e përshtatshëm të kantierit dhe respektimin e afateve të realizimit të kontratës.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike, relacioni teknik, preventivi i punimeve, vizatimet teknike, profilet karakteristike, detajet konstruktive dhe grafiku i ekzekutimit të punimeve për objektin “Zgjerimi i varrezave të fshatit Vuno” janë hartuar nga projektuesi i licencuar, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, aktet nënligjore në fuqi për projektimin dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit, standardet teknike shqiptare dhe europiane, si dhe rregullat e praktikës së mirë inxhinierike.

Objekti i investimit konsiston në zgjerimin dhe sistemimin e sipërfaqes së varrezave të fshatit Vuno, nëpërmjet realizimit të ndërhyrjeve të nevojshme infrastrukturore, konstruktive dhe funksionale, me qëllim krijimin e hapësirave të reja dhe të përshtatshme për funksionimin e varrezave, përmirësimin e aksesit dhe sistemimit të terrenit, garantimin e qëndrueshmërisë së elementeve mbajtëse dhe përmirësimin e ndriçimit të zonës.

Hartimi i dokumentacionit teknik është mbështetur në karakteristikat e terrenit dhe gjendjen ekzistuese të zonës, si dhe në nevojën për realizimin e punimeve të gërmimit, sistemimit, mbushjes, ndërtimit të elementeve mbajtëse, prishjes së elementeve ekzistuese dhe realizimit të elementeve të reja konstruktive dhe infrastrukturore. Dokumentacioni përcakton mënyrën e realizimit të proceseve të punës, parametrat teknikë, materialet dhe kërkesat që duhet të respektohen gjatë zbatimit të kontratës.

Referuar preventivit të punimeve, objekti përfshin punime gërmimi me mjete mekanike, punime dheu, ngarkim, transport dhe sistemim të materialeve të gërmuara dhe materialeve të ndërtimit, mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës dhe në zonat e përcaktuara nga projekti, si dhe realizimin e shtresave konstruktive dhe shtresave prej betoni sipas kuotave dhe parametrave teknikë të përcaktuar në projekt.

Një pjesë e rëndësishme e punimeve lidhet me realizimin e mureve mbajtëse prej guri dhe themeleve të tyre. Këto punime janë të nevojshme për stabilizimin e terrenit, kufizimin dhe mbajtjen e masave të dheut, si dhe për krijimin e kushteve të përshtatshme për sistemimin dhe

zgjerimin e sipërfaqes së varrezave. Muret prej guri dhe themelet duhet të realizohen sipas dimensioneve, kuotave, detajeve konstruktive dhe kërkesave të përcaktuara në dokumentacionin teknik të projektit.

Punimet e gërmimit me mjete mekanike janë parashikuar për krijimin e kuotave dhe hapësirave të nevojshme për realizimin e themeleve, mureve mbajtëse, shtresave të reja dhe elementeve të tjera të parashikuara në projekt. Gërmimet duhet të kryhen në mënyrë të kontrolluar, duke respektuar kuotat dhe profilin e projektuar dhe duke shmangur dëmtimin e elementeve ekzistuese që do të ruhen.

Materialet e rezultuara nga gërmimet dhe punimet e prishjes duhet të ngarkohen, transportohen dhe sistemohen ose largohen në përputhje me përcaktimet e projektit dhe legjislacionit në fuqi. Transporti i materialeve është pjesë e rëndësishme e organizimit të kantierit, pasi realizimi i punimeve kërkon menaxhimin e vazhdueshëm të materialeve të gërmuara dhe të materialeve të nevojshme për ndërtim.

Punimet e mbushjes me material të gërmuar në trupin e rrugës dhe në zonat e përcaktuara nga projekti janë parashikuar për sistemimin e terrenit dhe krijimin e bazamentit të përshtatshëm për shtresat e mëvonshme. Materiali duhet të vendoset, shpërndahet, nivelohet dhe ngjeshet në përputhje me kërkesat teknike dhe kuotat e projektit, në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e terrenit dhe e elementeve që do të realizohen mbi të.

Punimet e betonit janë parashikuar për realizimin e elementeve të ndryshme konstruktive dhe të shtresave prej betoni të përcaktuara në preventiv. Përgatitja, transporti, vendosja dhe përpunimi i betonit duhet të kryhen sipas kërkesave të projektit dhe specifikimeve teknike, duke garantuar parametrat e kërkuar të rezistencës, qëndrueshmërisë dhe jetëgjatësisë.

Në kuadër të punimeve janë parashikuar gjithashtu punime për prerjen dhe sistemimin e pemëve. Këto ndërhyrje janë të nevojshme për pastrimin dhe përgatitjen e sipërfaqeve ku do të zhvillohen punimet, si dhe për garantimin e kushteve të përshtatshme për realizimin e zgjerimit dhe sistemimit të territorit të varrezave. Prerja dhe sistemimi i pemëve duhet të kryhet në mënyrë të kontrolluar, duke respektuar elementet që do të ruhen dhe duke garantuar pastrimin e plotë të zonave të ndërhyrjes.

Për realizimin e elementeve funksionale të objektit janë parashikuar edhe punime për furnizimin, montimin dhe vendosjen e konstruksioneve metalike të thjeshta. Këto elemente duhet të realizohen sipas dimensioneve, formës, mënyrës së fiksimit dhe detajeve të përcaktuara në vizatimet teknike dhe specifikimet përkatëse.

Konstruksionet metalike të parashikuara duhet të trajtohen dhe të mbrohen nga korrozioni nëpërmjet punimeve të përgatitjes së sipërfaqes dhe bojatisjes, sipas kërkesave teknike të projektit. Përgatitja e sipërfaqeve metalike, aplikimi i shtresave mbrojtëse dhe bojatisja duhet të realizohen në mënyrë të tillë që të garantohet mbrojtja e elementeve dhe jetëgjatësia e tyre në kushtet e ekspozimit në ambient të jashtëm.

Në preventiv janë parashikuar edhe punime prishjeje të mureve prej guri ekzistues. Këto punime do të realizohen në zonat ku elementet ekzistuese nuk përputhen me zgjidhjen e re të projektit ose pengojnë realizimin e zgjerimit dhe sistemimit të varrezave. Prishjet duhet të kryhen në mënyrë të kontrolluar, duke shmangur dëmtimin e elementeve që do të ruhen dhe duke siguruar ngarkimin, transportin dhe sistemimin e materialeve të rezultuara.

Një komponent tjetër i rëndësishëm i objektit është instalimi i sistemit të ndriçimit. Punimet përfshijnë furnizimin dhe vendosjen e shtyllave të ndriçimit, instalimin e ndriçuesve, shtrimin dhe lidhjen e kabllave elektrike, si dhe vendosjen e tubacioneve plastike mbrojtëse për instalimet elektrike. Këto punime duhet të realizohen sipas skemave, pozicioneve, seksioneve dhe detajeve të përcaktuara në projektin elektrik dhe dokumentacionin teknik.

Shtyllat e ndriçimit dhe ndriçuesit duhet të jenë të përshtatshëm për përdorim në ambiente të jashtme dhe të plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në projekt. Kabllot elektrike duhet të kenë karakteristikat e përcaktuara në projekt dhe të vendosen në mënyrë të mbrojtur, ndërsa tubacionet plastike duhet të sigurojnë mbrojtjen mekanike të instalimeve dhe qëndrueshmërinë e tyre gjatë periudhës së përdorimit.

Çdo zë i preventivit është përcaktuar mbi bazën e projektit teknik dhe matjeve përkatëse, duke specifikuar sasinë, njësinë e matjes dhe karakteristikat e procesit të punës ose materialit që do të përdoret. Preventivi përbën bazën ekonomike të procedurës së prokurimit dhe mundëson që operatorët ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre mbi një bazë të njëjtë teknike dhe financiare, duke siguruar krahasueshmërinë e ofertave.

Specifikimet teknike përcaktojnë kërkesat minimale për materialet, elementet konstruktive dhe instalimet që do të përdoren në realizimin e objektit. Materialet e përdorura, përfshirë materialet e mbushjes, gurin për muret mbajtëse, betonin, elementet metalike, materialet mbrojtëse dhe të bojatisjes, shtyllat, ndriçuesit, kabllot dhe tubacionet plastike, duhet të jenë të përshtatshme për përdorimin e parashikuar dhe të plotësojnë kërkesat teknike dhe dokumentacionin përkatës të konformitetit dhe cilësisë, sipas legjislacionit në fuqi.

Vizatimet teknike, profilet karakteristike dhe detajet konstruktive janë hartuar me një nivel të përshtatshëm detajimi për të mundësuar interpretimin e njëjtë të punimeve nga operatorët ekonomikë dhe nga personeli përgjegjës për zbatimin dhe kontrollin e tyre. Ato përcaktojnë kuotat, dimensionet, seksionet, nivelet e gërmimit dhe mbushjes, pozicionet dhe përmasat e mureve mbajtëse, themeleve, shtresave, elementeve metalike dhe komponentëve të sistemit të ndriçimit.

Përcaktimi i saktë i kuotave dhe niveleve të terrenit, thellësive të gërmimeve, dimensioneve të themeleve dhe mureve mbajtëse, trashësive të shtresave dhe pozicionimit të elementeve të ndriçimit është i nevojshëm për të garantuar qëndrueshmërinë, sigurinë, funksionalitetin dhe jetëgjatësinë e objektit të përfunduar.

Grafiku i ekzekutimit të punimeve është hartuar duke marrë në konsideratë varësinë teknologjike ndërmjet proceseve të ndryshme. Në mënyrë të përgjithshme, punimet parashikohet të fillojnë me përgatitjen dhe pastrimin e zonave të ndërhyrjes, prerjen dhe sistemimin e pemëve, punimet e prishjes dhe gërmimit, vijnë me ngarkimin, transportin dhe sistemimin e materialeve, realizimin e mbushjeve dhe sistemimin e terrenit, ndërtimin e themeleve dhe mureve mbajtëse prej guri, realizimin e shtresave dhe elementeve prej betoni dhe më pas me instalimin e konstruksioneve metalike dhe sistemit të ndriçimit.

Kjo renditje teknologjike synon të sigurojë vijueshmërinë e punimeve, të shmangë ndërhyrjet e panevojshme ndërmjet proceseve të ndryshme dhe të krijojë kushtet për realizimin e çdo faze në përputhje me kërkesat e projektit dhe brenda afatit kontraktor.

Dokumentacioni teknik është hartuar në mënyrë që të sigurojë një kuptim të plotë dhe të njëjtë të objektit të prokurimit nga të gjithë operatorët ekonomikë, duke shmangur paqartësitë dhe

interpretimet subjektive. Specifikimet teknike janë formuluar mbi baza objektive dhe funksionale dhe nuk synojnë favorizimin e ndonjë operatori ekonomik, marke apo prodhuesi të caktuar.

Në çdo rast kur në dokumentacionin teknik përmendet ndonjë standard, produkt ose karakteristikë specifike, ajo duhet të kuptohet e shoqëruar me shprehjen “ose ekuivalente”, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Hartimi i dokumentacionit teknik është bërë në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe me nenin 40 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, duke respektuar kërkesat për qartësinë, objektivitetin dhe proporcionalitetin e specifikimeve teknike dhe duke garantuar akses të barabartë për operatorët ekonomikë.

Njëkohësisht, dokumentacioni teknik është hartuar duke respektuar parimet e përcaktuara në nenin 2 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, përkatësisht transparencën, proporcionalitetin, trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, konkurrencën efektive dhe përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë të fondeve publike.

Në përfundim, Autoriteti Kontraktor vlerëson se specifikimet teknike, preventivi, relacioni teknik, vizatimet, profilet, detajet konstruktive dhe grafiku i ekzekutimit për objektin “Zgjerimi i varrezave të fshatit Vuno” përbëjnë një dokumentacion teknik të plotë dhe të mjaftueshëm për zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe realizimin e punimeve.

Dokumentacioni përcakton qartë punimet e gërmimit, transportit dhe sistemimit të materialeve, punimet e mbushjes dhe përgatitjes së terrenit, realizimin e themeleve dhe mureve mbajtëse prej guri, punimet e betonit, prishjet e elementeve ekzistuese, prerjen dhe sistemimin e pemëve, realizimin e konstruksioneve metalike, punimet e mbrojtjes dhe bojatisjes së tyre, si dhe instalimin e shtyllave, ndriçuesve, kablllove dhe tubacioneve plastike të sistemit të ndriçimit.

Nëpërmjet këtij dokumentacioni synohet garantimi i realizimit të zgjerimit të varrezave të fshatit Vuno me cilësinë, sigurinë, qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin e kërkuar, si dhe përdorimi me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë i fondeve publike, në funksion të interesit publik dhe të qëllimit të investimit.

Gjithashtu, duke qenë se punimet do të realizohen në disa procese paralele dhe brenda një afati 3-mujor, sistemi i menaxhimit të cilësisë është i nevojshëm për koordinimin dhe kontrollin efektiv të aktivitetit ndërtimor në kantier.

NJËSIA E PROKURIMIT